



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Diasporës - Ministarstvo za Dijasporu - Ministry of Diaspora

Paneli “Roli i shqiptarëve në Perandorinë Osmane dhe në Republikën Turke”

Organizuar nga Qendra Kulturore e Kosovës, bashkë me Forumin Rinor të Shoqatës Vëllazëria Turko - Shqiptare, më 25 janar 2014, në Qendrën Kulturore të Kosovës u mbajt paneli me temën “Roli i shqiptarëve në Perandorinë Osmane dhe në Republikën Turke”.

Në panel ishin të ftuar të gjitha shoqatat shqiptare, kosovare, si dhe shoqata të të shpërngulurve nga vendet ballkanike në Turqi që veprojnë qytete të ndryshme. Të pranishëm në këtë panel ishin edhe ambasadori i Republikës së Kosovës në Turqi, z. Avni Spahiu, dhe konsulli i përgjithshëm i Republikës së Kosovës në Stamboll, z. Rrahim Morina.

Në këtë panel, folësi ishte shtetas turk, jo me origjinë nga Ballkani, sociolog-studiuues-kolumnist z. Müfit YÜKSEL.



Paneli e hapi drejtori i Qendrës Kulturore të Kosovës, z. Qamil Bytyçi.

Pastaj fjalën e mori folësi i panelit z. Müfit YÜKSEL. Ai tha: “Rreth 5 – 6 milionë shqiptarë jetojnë në Turqi, ky numër pothuajse është dyfishi i popullatës së Shqipërisë”. Disa nga pikat e diskutimit të z. Yüksel:

- Osmanët janë vendosur në Kosovë pas vitit 1389 dhe për shkak se grekët shqiptarët e Jugut i kanë quajtur arvanitë, ndërkaq turqit i quajtën shqiptarët arnavutë.
- Pas vitit 1432, në dokumentet osmane hasim në të dhëna për shqiptarët.
- Elementi më i fuqishëm i Perandorisë Osmane ishin shqiptarët, të cilët luajtën rol të rëndësishëm në periudhën e rritjes, zhvillimit dhe rënies së Perandorisë Osmane. Shqiptarët, sidomos pas Fatih Sultan Mehmetit, ishin shumë aktivë.
- Sadriazemi (kryeministri i sotëm) i parë me origjinë shqiptare në Perandorinë Osmane ishte Ahmet Gedik Pasha nga Vlora.
- Në historinë osmane, në disa vise të largëta të Perandorisë Osmane hasim administratorë, siç janë Egjipti, Algjeri, Maroku etj.
- Perandoria Osmane aq sa ka qenë shtet i turqve, ka qenë edhe shtet i shqiptarëve.
- Neni 18 (i bërë nga xhonturqit e rinj) në Parlamentin Osman, në kohën e Tanzimatit, ka qenë antishqiptar dhe ka shkaktuar shkëputjen e Shqipërisë nga Perandoria. Në këtë nen thuhet: “Çdo nëpunës që punon në administratën e Perandorisë Osmane duhet ta dijë gjuhën turke”. Shqiptarët më së shumti e kanë kundërshtuar këtë nen.
- Janë mbledhur armët e shqiptarëve, dhe kjo ka shkaktuar revoltë tek ta.
- Me shkëputjen e shqiptarëve, osmanët e humbën pjesën e Rumelisë së Perandorisë.
- Rumelia ka qenë truri i Perandorisë Osmane.
- Prishja e Lidhjes së Prizrenit ishte gabim i Perandorisë Osmane.